

Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Data: 29/05 /2018
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	Nr. 020-586
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi nr. 421/01-27092 për shfuqizimin e vendimit nr. 421-3587 të datës 19.06.2009 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NTSH "BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gecaj komoran
I miratuar më datë: 04.05.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.05.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi***. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim. Vendimi dhe ky vlerësim nuk mohojnë të drejtën e palëve të pakënaqura për pretendime që dalin nga kontrata për të drejta dhe detyrime, konteste këto që duhet të zgjidhen nga gjykata ashtu siç është përcaktuar me kontratë.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština- MALS	Datum, 29/05 /2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine	Br. 020-586
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obaveznu rapsravu zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 421/01-27092 o ukidanju Odluke br. 421-3587 od dana, 19.06.2009. godine, za korišćenje nepokretne imovine opštine NTSH "BE-INGENIERINBAU" sa vlasnikom Gëzim Gecaj iz Komorana.

Usvojena dana, 04.05.2018. godine,

Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 14.05.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 14.05.2018
-U1- 020-586



12 Nr 421/01-27092 dt. 11/05/2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit të Komunës së Drenasit, ninit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, për pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale Nr.202 dhe 201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullit më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHIFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 421-3587 TË DATËS 19.06.2009, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM NTSH "BE-INGENIERINBAU" ME PRONAR GËZIM GEGAJ NGA KOMORANI

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonën Kadastrale në Komoran, që i ishte dhënë në shfrytëzim NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.202 dhe 201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, në shfrytëzim të përkohshëm për 10 vite .

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.421-3587 i datës 19.06.2009 i komisionit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 401-6064 e datës 06.07.2009, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.202-201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Handwritten Signature]
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit – Komisioni për shqyrtimin e kërkesave sipas shpalljes publike

01 Nr.421- 3587 , me datën 19 . 06 . 2009 .

Duke vendosur sipas kërkesave të parashtruara , shpalljes publike dhe plotësimit të shpalljes publike nr.462-1720 të datës 20.03.2009 , Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Dhënies së Tokës Komunale në Shfrytëzim të Përkohshëm 012 nr.351-183 të datës 31.12.2004 , Komisioni i caktuar në bazë të Vendimit 01 nr.421-749 të datës 04.02.2009 , mori këtë :

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E PËRFITUESVE PËR MARRJEN E TOKËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM (ME QIRA)

I. Caktohen përfituesit për marrjen e tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm , sipas shpalljes publike 01 nr.462-1720 të datës 20.03.2009 , si vijon :

- Zona Kadastrale Sankoc , përfitues është :
 1. Rrahim Elshani nga Rezistenca , Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm (me qira) prona komunale , pjesa e ng.kadastrale nr.258 , e shënuar në fl.poseduse nr.147 , z.kadastrale Sankoc , në sipërfaqe prej 0.59,52 ha .
 2. NTSH"LEONITI"-Komoran , me pronar Bujar Obrija nga Komorani , i ipet në shfrytëzim të përkohshëm (me qira) prona komunale , pjesa e ng.kad.nr.258 , e shënuar në fl.pos.nr.147,z.kad.Sankoc , në sipërfaqe prej 0.59,50 ha .
 3. SHPK "PETROL OTI SLOVENIA" Prishtinë-Mitrovicë , i epet në shfrytëzim të përkohshëm(me qira) prona komunale , pjesa e ngastrës kadastrale nr.256 , e shënuar në fl.pos.nr.147,z.kad.Sankoc , në sipërfaqe prej 1.00,00 ha .
 4. Nexh Lladrovci nga Shkaba(Gllanasella), Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm (me qira), prona komunale , pjesa e ng.kad.nr.256 , e shënuar në fl.poseduse nr.147 , z.kadastrale Sankoc , në sipërfaqe prej 0.97,00 ha .
 5. SMH "KOSOVA" –Bek Maloku nga Klina , i epet në shfrytëzim të përkohshëm (me qira) , pjesa e ng.kad.nr.258 , e shënuar në fl.poseduse nr.147 , z.kad.Sankoc , në sipërfaqe prej 0.59,50 ha .
- Zona Kadastrale Komoran , përfitues është :
 1. Bashkim Demaj nga Abri e Epërme , Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesë e ngastrës kadastrale nr.1/2 e shënuar në fl.pos.nr.187 , z.kad.Komorani , në sipërfaqe prej 0.20,00 ha .
 2. N.P.SH. " EURO – B " Komoran – Sala Shala-Gjoshi nga Sankoci , Komuna e Drenasit , i ipet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesë e ng.kad.nr.1/2 , e shënuar në fl.pos.nr.187 , z.kad.Komorani , në sipërfaqe prej 0.10,00 ha .
 3. N.T.P."FLORJANI"Komoran-Muhamet Ajazi nga Komorani , Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesa e ng.kad.nr.1/2,e shënuar në fl.pos.nr.187 , z.kad.Komorani , në sipërfaqe prej 0.10,00 ha .
 4. N.T.SH. " Be - Ingenieurbaubau " Komoran – Gezim Gegaj nga Komorani , Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , ngastra kadastrale nr.202-201, e shënuar në fl.pos.nr.187 , z.kad.Komorani , në sipërfaqe prej 0.40,00 ha .

- Zona Kadastrale Gllobar , përfitues është :
1. N.T.P "BESI COMERC" Glllogoc-Mustaf Morina nga Gllbari , Komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesë e ng.kad.nr.438 , e shënuar në fl.poseduese nr.109,z.kadastrale Gllobar , në sipërfaqe prej 0.03,00 ha.
 2. N.T.Eksport Import "FER PETROL" – Mehdi Gjoka nga Tërstenik , Komuna e Drenasit , i ipet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesa e ngastrës kadastrale nr.503 , e shënuar në fl.pos.nr.109, z.kadastrale Gllobar , në sipërfaqe prej 0.40,00 ha.
- Zona Kadastrale Abri e Epërme , përfitues është :
1. Felmi Demaku nga Abria e Eperme , komuna e Drenasit , i epet në shfrytëzim të përkohshëm , prona komunale , pjesa e ng.kad.nr.1905/3 , e shënuar në fletën poseduese nr.209 , z.kadastrale Abri e Epërme , në sipërfaqe prej 0.10,00 ha .

II. Kushtet e veçanta për marrjen e tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm (me qira),për personat fizik dhe juridik të cilët kanë përfituar , do të caktohen me kontratë e cila kontratë do të lidhet në mesë të Komunës së Drenasit dhe Përfituesit , në afat prej 30 dite , nga dita e shpalljes së përfituesve.

III. Një kopje e këtij Vendimi do të publikohet në vendin për shpallje publike të KK.Drenasit , një kopje i dërgohet Kryetarit të Komunës së Drenasit , për vazhdimin e procedurës së mëtutjeshme dhe një kopje në dosjen e organit .

Drenas , me 19.06.2008



K o m i s i o n i :

1. Isak Bytyqi , Jur.i Dip.

2. Xhavit Nebihu, Jur.i Dip.

3. Fadil Tahiri , Gjeodet

[Handwritten signatures of the commission members]



Republika e Kosovës
Komuna Drenas

Për : Zyra e Kryetarit

z.Nexhat Demaku

Nga: Komisioni për verifikim të ndërtimeve

Datë: 08.10.2010

Lënda: **Procesverbal.**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLLOGOC GLLLOGOC MUNICIPALITY			
Pencuar		21.10	2010
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	301	8133	

Komisioni i caktuar nga zyra e Kryetarit për verifikimin e ndërtimeve në parcelat e dhëna me qera në afat të përkohshëm prej 10 vitesh me dt.08.10.2010 ka dalë në vendshqim dhe ka konstatu me sa vijon:

Përfituesit e parcelave të cilën kanë fillu ose janë në proces të ndërtimit janë :

Gllobar

1. "Fer Petrol" Mehdi Gjoka në ndërtim Kontrata nr. 462/4634 dt:06.07.2009 ngastra nr.503 në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha .
2. "Besimi Comerc " Mustaf Morina në ndërtim me kontratë nr. 462/5516 me dt.06.07.2009 ngastra nr. 438 në sipërfaqe prej : 0.03.00 ha
3. Shaip Morina në ndërtim kioskë veprimtari prodhuese Blloka betoni. Kontrata nr.421/273 dt: 10.05.2005 ngastra nr.438/3 nw sipërfaqe prej 0.05.00 ha

Komoran

1. Kastriot Gashi Pomp Benzine kontratat nr.952/1922 dt.25.03.2009 ngastra nr. 244/4 nw sipërfaqe prej :S=0.20.00 ha
2. "Euro – B" Sala Gjoshi në ndërtim Kontrata nr. 465/1036 dt:13.05.2010 ngastra nr ½ sipërfaqe prej S=0.10.00 ha
3. "Floriani" Muhamet Ajazi në ndërtim Kontrata nr.462/4010 dt:06.07.2009 ngastra nr.1/2 në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha.
4. " SHPK" TECH ENERGY KOSOVA" Ali Kastrati në ndërtim kontrata nr.462/4005 dt.09.07.2009 ngastra nr.144/2 në sipërfaqe prej S=0.31.00 ha.

Përfituesit e parcelave të cilët **NUK** kanë fillu me ndërtimit janë :

Ne tokat e dhëna me qera në Sankoc

1. **NTSH" Leoniti "** – nga Komorani me pronar **Bujar Obrija** nga Komorani kontrata e dt:06.07.2009 ngastra nr. 258 në sipërfaqe prej S=0.59.50 (KONTRATA NUK ËSHTË E NËNSHKRUAR)
2. **Rrahim Elshani** – nga Baica (**Mungon Kontrata**)
3. **SHPK"Petroll Oti Sllovenija"** Kontrata nr.453/3970 dt.06.07.2009 ngastra nr.256/2 në sipërfaqe prej :S=01.00.00 ha.
4. **Nexh Lladrovci** nga Shkaba (**Gillanasella**) Kontrata nr.462/3979 dt:06.07.2009 ngastra nr. 256/1 në sipërfaqe prej : S=0.97.00 ha
5. **SMH"KOSOVA"** Bek Maloku nga Klina Kontrata nr.462-4013 dt:06.07.2009 me nr. Ngastres 258/3 me sipërfaqe prej 0.59.50 ha

Në tokat e dhëna me qera në Komoran

1. **NTSH " Be-Ingienierungbau"** Komoran **Gezim Gegaj** nga Komorani , Kontrata nr.421-6064 dt:06.07.2009 ngastra nr.201-202 siperfaqe prej : S=0.40.00 ha
2. **Bashkim Demaj** nga **Abria e Epërme** , Kontrata nr.462/2158 dt.06.07.2009 ngastra nr.1/2 nw sipërfaqe prej : 0.20.00 ha
3. **Ramadan Jollë Bytyqi** nga **Arllati** kontrata nr 421/1625 dt.16.03.2009 ngastra nr.1/2 me sipërfaqe prej : S=0.40.00 ha

Raportin e përpiloi:

Haki Bekolli , kryetar i komisionit

Fadil Tahiri , anëtar

Besim Tahiraj anëtar





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

Zyra e Kryetarit

Nr. 421-6064

Dt: 06.07. 2009

K O N T R A T Ë
MBI DHËNJEN E TOKËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM TË
PËRKOHSHËM.

E LIDHUR MË DATËN 06.07.2009 NË MES :

1. Komunës së Drenasit të cilin e përfaqëson Kryetari i Komunës Z.Nexhat Demaku në tekstin e mëtejme: Dhënësi i tokës në shfrytëzim.
dhe
2. Ntsh "BE-INGENIERINGBAU" Gezim Gegaj nga Komorani Komuna Drenas (në tekstin e mëtejme, shfrytëzuesi i tokës.

I.

Në vështrim të nenit 14.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2.1 të Rregullores nr.2005/13 mbi Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Shoqërore që Administrohet nga Komunitet e Kosovës , Nenit 9 të Rregullores për procedurat dhe kriteret e dhënies së tokës komunale në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin e objekteve afariste në territorin e Komunës së Drenasit nr. 012-351-183 të datës 31.12.2004, Rregullores nr.031-520 të datës 04.09.2007 për caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve dhe taksave Komunale për aplikim në territorin e Komunës së Drenasit dhe Vendimit nr.421 -3587 të datës 19.06.2009 të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës komunale, Komuna i jep NTSH "BE-INGENIERINGBAU" Gezim Gegaj nga Komorani tokën në shfrytëzim të

përkohshëm me qëllim të shfrytëzimit për Afarizem .Toka e cila ipet në shfrytëzim të përkohshëm gjendet në Ngastrën kadastrale nr: 202-201 me kulturë tokë ndërtimore në vendin e quajtur "Fusha gjerë " zona kadastrale Komorani e evidentuar në fletën poseduese nr 187 Pasuri e Komunës së Drenasit.

II.

Toka e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm është pjesë e ngastrës nr 201-202 në sipërfaqe prej: 0.40.00 ha dhe gjendet në zonën tatimore Nr. 1 e përcaktuar sipas Vendimit 465/49 të dt.07.02.2003 të Kuvendit të Komunës së Gllogocit për caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve ,taksave komunale për aplikim nr.110/126 dhe ka çmimin për m² 2 € në vit . Për çdo vonesë të pagesës së qerasë do t'i shtohet kamata ditore prej 0.02 % në vlerën e përgjithshme vjetore edhe nëse pas kësaj mase nuk paguhen obligimet atëherë do të fillojnë procedurat për shkëputjen e kontratës .

III.

Toka ipet në shfrytëzim të përkohshëm për 10(dhjetë)vite, për realizimin e programit investiv të paraqitur nga ana e NTSH "BE-INGENIERINGBAU" Gezim Gegaj nga Komorani dhe të aprovuar nga Komuna e Drenasit

IV.

Shfrytëzuesi i tokës me kontratë , NTSH "BE-INGENIERINGBAU" Gezim Gegaj nga Komorani , pajtohet se parcelën e marr në shfrytëzim do ta shfrytëzojë sipas pikës III të kësaj kontrate dhe merr këto obligime :

1. Në këtë parcelë do të ndërtoj objektin tërësisht sipas kushteve tekniko-urbanistike dhe lejes për ndërtim që i lëshohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit
2. Që të filloi punën në afat prej: 3 muajsh dhe ta përfundojë mbrenda një viti
3. Që të marr lejen e ndërtimit dhe të përdorimit të objektit ;
4. Kontraktuesi i tokës , nuk mundë të ia jap të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe objektit një personi tjetër ;
5. Kontraktuesi obligohet që ç`do vit të paguaj qiranë për marrjen e tokës në shfrytëzim në shumë prej: 8000 € për çdo vit, në gjyrollogarinë e Komunës së Drenasit nr: 1000650070000022 kodë 40-pranë Autoritetit Bankar të Kosovës.
- 6.

V.

Toka i ipet me kontratë në shfrytëzim të përkohshëm për 10(dhjetë)vite, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate me mundësi të vazhdimit të kontratës.Palët kontraktuese kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata duke e respektuar afatin e tërheqjes prej 6 muajsh,terheqja nga kontrata ipet me shkrim.Nese paraqitet ndonjë interes i përgjithëshem për këtë sipërfaqe do të vendoset sipas legjislacionit në fuqi.

VI.

Pagesa e qirasë për token komunale të marr në shfrytëzim do të filloj të llogaritet pas përfundimit të objektit dhe me fillimin e punës. Nëse Shfrytëzuesi nuk i plotëson kushtet për lirim nga qiraja sipas rregullores në fuqi obligohet që qiranë ta paguan sipas Rregullores në fuqi.

Palët kontraktuese u pajtuan se çmimi për shfrytëzimin e tokës komunale sipas kësajë kontrate mund të ndryshohet nëse dhënsi i tokës në shfrytëzim e ndryshon Vendimin mbi caktimin e ngarkesave dhe detyrimeve si dhe taksave komunale pas aprovimit nga organi kompetent.Pagesa e qirasë për obliguesin, duhet të bëhet më së largu në fund të çdo gjashtëmujori, në të kundërten do të përllogaritet kamata sipas dispozitave ligjore.

VII

Shfrytëzuesi i tokës komunale i cili i plotëson kushtet sipas nenit 4 dhe 5 të Rregullorësë mbi shfrytëzimin e tokës komunale do të lirohen nga pagesa e qirasë, mirpo nëse ndërkohë nuk i përmbahet dispozitave të theksuara më lartë të kësajë Rregulloreje obligohet të paguaj qiranë për shfrytëzimin e tokës komunale sipas tarifës komunale në fuqi.Poashtu edhe shfrytëzuesit e tokës komunale të cilët me rastin e marrjës së kësajë toke nuk i kan plotësuar kriteret për lirim nga qiraja e në ndërkohë i plotësojnë këto kriteret do të lirohen nga qiraja.Kjo qeshtje do të rregullohet me një aneks kontratë.

VIII

Shfrytëzuesi i tokës komunale obligohet të njoftoj Drejtorinë Komunale për Financa që i ka kryer obligimet ndaj punëtorve të punësuar lidhur me pagesën e pagave bruto , që nënkupton pagën neto së bashku me tatimin dhe kontributin.Njoftimi duhet të bëhet pas qdo periode tre mujore.

IX

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë, që pas nënshkrimit të kësajë kontrate nga palët kontraktuese të bënë regjistrimin katastral në regjistrat e palujtëshmerive si shfrytëzues i përkohshëm i kësajë toke.

X

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshme të tokës komunale është kontratë formale që duhet të përpilohet me shkrim. Çdo gjë që nuk është paraparë sipas kësaj kontrate,do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi tokën ndërtimore,të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore .

XI

Shfrytëzuesi i lokacionit i bartë shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt të cilat janë të nevojshme për të pasur mundësi të funksionimit si dhe të paguaj shpenzimet e rrymës, të ngrohjes, të ujit dhe komunalit tjera në funksion të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtij objekti që do të ndërtohet në këtë tokë ndërtimore dhe pas përfundimit obligohet që tokën ndërtimore ta kthej në gjendje që e ka pranuar.

XII

Në rast kontesti sipas kësaj kontrate , kompetente për vendosje do të jetë Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë.


XIII

Kjo kontratë është e hartuar në katër ekzemplar të njëjtë prej të cilave nga dy kopje për palët kontraktuese, si dhe nga një kopje për organet kompetente.

PALËT KONTAKTUESE :

SHFRYTËZUESI I TOKËS:

NTSH "BE-INGENIERINGBAU" Gezim Gegaj
nga Komorani



DIHËNËSI I TOKËS NË SHFRYTËZIM





Republika e Kosovës
Komuna Drenas

Për : NTSH " Be-Ingienierungbau" Komoran Gezim Gegaj nga Komorani

Nga: Zyra e Kryetarit të Komunës Drenas

Kryetar: z.Nexhat Demaku

Datë: 22.10.2010



Lënda: Njoftim lidhur me shkëputjen e Kontratës nr. 421-6064 , Dt.06.07.2009

- NTSH " Be-Ingienierungbau" Komoran Gezim Gegaj nga Komorani me shprehje të vullnetit të lirë me dt. 06.07.2009 ka lidhur kontratë me Kryetarin e Komunës së Drenasit lidhur me marrjen e tokës në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin e lokalit afarist.

Në bazë të nenti 3 pika II të kontratës në fjalë NTSH " Be-Ingienierungbau" Komoran -Gezim Gegaj nga Komorani ka qenë e obliguar që ta filloi ndërtimin e objektit në afatin prej 3 muajsh , nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate duke iu përmbajtur kushteve tekniko-urbanistike.Me dt. 07.10.2010 Kryetari i Komunës së Drenasit ka formuar komisionin për verifikimin e gjendjes faktike në teren ku sipas këtij komisioni NTSH " Be-Ingienierungbau" Komoran Gezim Gegaj nga Komorani nuk ju ka përmbajtur kontratës në fjalë (nuk ka filluar ndërtimin e objektit) ku në bazë të kësaj ka humbur të drejtën ligjore për ndërtimin e objektit , andaj Zyra e Kryetarit të Komunës ka vendosur që kjo kontratë të shkëputet dhe të konsiderohet jo ligjore.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KRYETARI I KOMUNES
Nr. 463/4827 me datën 04.02.2014

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Vendimit mbi ndërprerjen e Kontratave mbi dhënien e tokës Komunale në shfrytëzim të përkohshëm nga ana e Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. DËTYROHET Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi I Komunës së Drenasit përkatësisht Sektori për regjistrim kadastral në RDPP të bej çregjistrimin nga RDPP-ja, palujtshmerinë komunale të regjistruar në emër të NTSH "Be-Ingjenierungbau" I përfaqësuar nga pronari Gëzim Gegaj ngg Komorani, Komuna e Drenasit I dhënë në shfrytëzim në bazë të Kontratës mbi dhënien e tokës Komunale në shfrytëzim të përkohshëm nr.462-6064 të dates 06.07.2009 sepse kjo kontratë është anuluar në menyre të njëanshëm nga Komuna për mos përmbushjen e detyrimeve sipas kontratës nga shfrytëzuesi I kësaj toke me çera.
- II. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë I Komunës së Drenasit, ta përmbaroj këtë Vendim duke çregjistruar nga RDPP-ja, pronën e palujtshme komunale e cila evidentohet në pjesën e ngastrave kadastrale nr.201 dhe 202 në sipërfaqe prej 0.40,00 ha, në zonën kadastrale "Komoran" e cila është e regjistruar si shfrytëzues në emër të përfituesit NTSH "Be-Ingjenierungbau" me seli në Komoran, Komuna e Drenasit dhe tani e tutje të regjistrohet si prone publike e Komunës së Drenasit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtori i Drejtoratit për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë I Komunës së Drenasit permis shefit të Sektorit të Zyrës së regjistrimit të palujtshmerive në Komunën e Drenasit, ndërsa për monitorim e zbatimin të këtij Vendimi kujdeset Kryetari I Komunës.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPI-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.



KRYETARI I KOMUNËS
[Signature]
NEXHAT DEMAKU



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR/ MINISTARSVOSREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJAJ/ MINISTRY OF

Formulari nr. 5

Nr. i lëndës/protokolit 463-4827

Komuna: Glllogoc

Zona Kadastrale: Komoran

Në mbështetje të Nenit 3 al. 3.6 dhe 3.7 të Ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme Ligji Nr. 2002/5 dhe 2003/13, në bazë të kërkesës së Komunës së Drenasit me dt.04.02.2014 Drejtorati për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë KK. Glllogoc, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

I. APROVOHET – Kërkesa e Komunës së Drenasit e cila ka të bëjë me çregjistrim të pronësisë Pronë Komunale KK Glllogoc shfrytzues I përkoshem për 10 vite Gëzim Gega nga Komorani nga pjesa e Parcela kadastrale Nr.201 dhe 202 me sipërfaqe prej 0.40.00 ha zona kadastrale Komoran komuna Glllogoc.

Arsyetim

Z/zj Komuna e Drenasit ka parashtruar kërkesën pranë Zyrës Kadastrale të Komunës Glllogoc për çregjistrim e pronësisë në Regjistrin e Paluajtshmërive dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrim në Regjistrin e Paluajtshmërive (lloji i dokumentit):

Vendim mbi nderprerjen e kontratave mbi dhënjën e tokës komunale në shfrytzim të përkoshëm nr.463-4827 dt.04.02.2014 .

Sipas gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për çregjistrim sipas Ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligji Nr. 2002/5 dhe 2003/13 dhe nenit 5 e 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. MPSH 2004/03 mbi Zbatimin e Ligjit mbi regjistrin.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkoj nga ZKK rishqyrtimin e këtij aktvendimi. Aktvendimi I dorzohet:

Arkivit,

Shërbimit përkatës, Parashtruesit të kërkesës

Datë 21.02..2014



DREJTORI

Mehdi Kurrumeli jur.dip.